**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

# RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

| | | |
|---|---|---|
| ***Naser Fejzullahu***<br>***Ekspert Shqyrtues*** | ***Data e autorizimit të ekspertit***<br>**28.06.2022** | ***Data e dorëzimit të raportit***<br>07.07.2022 |

## 1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Datën: 27.06.2022, **MONUNI SHPK** ka parashtruar ankesë me **Nr: 235/22** , kundër Njoftim Vendimit mbi dhënien të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor 616-22-5704-2-1-1, dhe nr. brendshëm 616 22 83 211** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) **– KK Prishtina**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedura të hapur, lloji i kontratës: **Shërbime, vlera** e parashikuar e kontratës**: 450,000.00 € vlere e madhe.**

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë 10.06.2022, data e hapjes së ofertës 21.06.2022, data e njoftimit për pezullim te Aktivitetit te Prokurimit 28.06.2022.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

## Ankesa e OE

## MONUNI SHPK

**Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

| | |
|---|---|
| Neni 1 - | Qellimi i aktivitetit te prokurimit |
| Neni 7 - | Barazia ne Trajtim / Jo-Diskriminimi |
| Neni 69 - | Aftesia Teknike dhe/ose Profesionale |

Keto terme Jane perdorur shume here ne tekstin e meposhtem prandaj edhe i kemi perdorur shkurtesat qe kane domethenie sine vijim:
AK- Autoritet Kontraktues OE- Operator Ekonomik
FOT- Fleta e te dhenav te tenderit LPP- Ligji i prokurimit publik
UOPP- Udhezimi operativ per prokurim publik

**Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet**

Shkelje e Nenit 1, Qellimi i aktivitetit te prokurimit. Qellimi i procedurave te prokurimit eshte gjetja e nje OE i cili i permbushe kriteret e nevojshme per te deshmuar se do ta realizoje me sukses kontraten dhe cmimi i tij i ofruar eshte me i liri nga konkurrentet. Autoriteti kontraktues ne kete rast per tu siguruar se OE fitues do ta realizoje me sukses dhe pergjegjesi profesionale kontraten, ne dosjen e tenderit ka vendosur me te drejte edhe kriterin qe OE ofertues duhet te jete i licencuar per te ushtruar veprimtari te DDD-se te leshuar nga ministria perkatese. Por vendosja e kriteri per staf shtese te kualifikuar per tituj akademik te caktuar eshte standarde i dyfishte dhe bie ne kundershtim me qellimin e aktivitetit te prokurimit.

Si dhe vlera e parashikuar eshte shume e larte ne krahazim me çmimet e tregut. Prandaj, koficienti i kerkeses per referenca duhet te kalkulohet mbi bazen e vleres reale te tregut.

Shkelje e Nenit 7, Barazia ne Trajtim / Jo-Diskriminimi. Autoriteti kontraktues me rastin e shpalljes se Njoftimit per kontrate dhe dosjes se tenderit ka vendosur kritere diskriminuese, duke kerkuar staf shtese te kualifikuar per tituj akademik te caktuar dhe neglizhuar kriterin baze qe ka te beje me licencen e leshuar nga institucionet perkatese per te ushtruar veprimtarine profesionale per ofrimin e sherbimeve te natyres se njejte siq ka kerkuar AK.

Ne kerkeses per informata shtese te dates 18.06.2022 dhe ne kerkese per rishqyrtim te dates 24.06.2022 drejtuar AK nga ana jone nder tjerash eshte theksuar se: Me rastin e marrjes se licences per te ushtruar veprimtari te DDD-se ne ministrine perkatese, kerkohet angazhimi i stafit te kualifikuar siq e parasheh ligji. Ju keni kerkuar Licence nga Ministria perkatese per kryerjen e sherbimeve te DDD-se. Kerkesa nga ju per licence te DDD-se eshte e arsyeshme por kerkesa per staf shtese te kualifikuar per tituj akademik te caktuar eshte nje anomali e cila bie ne kundershtim ne mes te ketyre dy kerkesave. Besojme shume se ky ka qene nje leshim i paqellimshem nga ana e Autoritetit Kontraktues sepse nje kriter i tille favorizon nje Operator Ekonomik por pa te drejte diskriminon te tjeret. Kjo bjen ne kundershtim me parimet e LPP sepse ne kete menyre zvogelohet konkurrenca dhe rritet kostoja e shpenzimeve publike, ku ne anen tjeter demtohet tregu konkurrues. Me rastin e leshimit te licences se DDD-se, Arsyetimi i cekur ne licence thote: Drejtori i Departamentit

te Politikave Bujqesore dhe Tregtise, duke u bazuar ne kerkesen e ushtruar nga OE me seli ne X me nr.00 te dt. dd.mm.vvvv dhe dokumentacionit te bashkangjitur (çertifikata e regjistrimit te biznesit nga Ministria e Tregtise dhe Industrise, lnformata mbi biznesin nga Zyra e Regjistrimit te Ndermanjeve Biznesore dhe Emrave Tregtare nem Kosove, certifikata e numrit fiskal nga Ministria e Finacave dhe Diploma e Fakultetit te Bujqesise, Agronomise, Veterinarise, Epidemiologjise dhe Ekologjise), per kryerjen e puneve profesionale te Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit, ne pajtim me nenin 51 paragrafi 3 nenparagrafi 3.6 Ligji Nr. 04/L-120 per Mbrojtjen e Bimeve, te dt. 17.01.2013 dhe ne mungese te aktit nenligjor qe e percakton rregullimin e kesaj fushe, merr vendim qe ti leshohet **leje e perkoheshme** per kryerjen e puneve profesionale te Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit ne afat te caktuar nga dt. dd.mm.vvvv deri me dd.mm.vvvv. (dokument i bashakngjitur)

Siq shihet ligji qe e rregullon kete çeshtje, titujt akademik te lartcekur ju ka dhene barasvleren e njejte. Por AK e ka vequar dhe i ka dhene vlere me te madhe Epidemiologute diplomuar dhe titujve tjere, krahas tjerave.

Shkelje e Nenit 69, Aftesia Teknike dhe/ose Profesionale. Nje aktivitet te njejte te prokurimit e kemi pasur edhe me nje Autoritet Kontraktues, pas ankeses ne OSHP ky aktivitet i prokurimit eshte drejtuar ne rruge te drejte. Ne raporin e ekspertit shqyrtues Nr.492/15 date 30.11.2015 tek konstatimi nr.2 thuhet: *Eksperti shqyrtues teknik, gjate ekzaminimiL te dosjes se tenderit konstaton se ne pretendimin qe eshte shkelur Neni 7- Barazia ne Trajtim I Jo Diskriminimi e OE ankues, qendron sepse AK tek kerkesat e pershtatshmerise profesionale tek aneksi 9.1 tek Lista e stajit me specifikimet e kualifimeve shkollore, ka kerkuar se paku nje epidemiolog te diplomuar dhe 2 teknik sanitar (ku thuhet se ato qe nuk i kane duhet te bejne marrveshje me stafin e kerkuar). Konstatoje se nuk duhet te kerkohet epidemiolog sepse vet posedimi i licecimit per DDD, nenkupton qe OE ka te drejte te kryej punet e deratizimil, dezinfektimit dhe desinsektimit. Ne te kunderten kerkesa shtese per epidemiolog shkel ligjin Nr 7 duke diskriminuar OE ne fjale. Duke patur parasyshe vendimin e nxjerrurr nga Drejtori i Departamentit te Politikave Bujqesore dhe Tregjeve te Ministrise se Bujqësisë·, Pylltarise dhe Zhvillimit Rural, ne mbeshtetje te nenit 145 (paragraji 2), te Kushtetutes se Republikes se Kosoves, duke marre parasysh nenin 38 te Ligji.t nr. 03/L-189 per Administraten Shteterore te Republikes se Kosoves (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, dt. 21.10.2010, duke u bazuar ne nenin 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) te Rregullores nr. 02/2011 per_fushat e pergjegjesise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011). neni 5 (paragarafi 5.4. c) te Rregullores 2001/19 per Degen e Ekzekutivit, ne pqjtim me nenin 51 paragrafi 3 nenparagrafi 3.6 Ligji Nr. 04/L-l 20 per Mbrojtjen e Bimeve (Gazeta Zyrtare e Republikesse Kosoves Nr. 1/17 Janar 2013), nxjerr:*

*VENDIM*

*Per dhenien e lejes se perkohshme I LEJE PER REGJISTRIM TE DDD*

1. *Kerkesa per leje.*
2. *Certifikaten e biznesit nga Ministria e Tregtise dhe Industrise.*

3. *Certifikaten e numrit jiskal nga Ministria e Financave.*
4. *Diploma per pergaditjen pro.fesionale (Fakulteti i Bujqesise, Agronomise, Veterinarise, Epidemiologjise, Ekologjise).*
5. *Procesverbalin nga inspektori.fitosanitar.*
6. *Fletepagesen e takses per leje ne vlere pre 40€*

*Ketu shihet qarte se diploma per pergatitje pro.fesi.onale duhet te jete personi qe ka te ktyer njerin nga keto .fakultete: fakultetin e Bujqesise, Agronomise, Veterinarise, Epidemiologjise ose Ekologjise dhe nuk ijep pe,paresi njerit nga tjetri.*

*Rekomandojme qe ne te ardhmen AK te mos kerkoje kritere shtese per kryerjen e sherbimeve te DDD, por mjafton vetem kerkesen e licences per DDD nga organet kompetente, duke mos shkelur nenin 7 te LPP ne.fuqi.*

OSHP dhe AK ndaje te cilit eshte here ankesa jane pajtuar me mendimin e ekspertit, OSHP ne kete rast me vendimin e saje Nr. 492/15 date 10.12.2015 ka aprovuar ne tersi pretendimet tona (Dokument i bashkangjitur).

Besojme se tani kemi nje precedent te nxjerre nga OSI-IP per kete c;:eshtje.

Kerkojm nga ju qe te rishiqoni keto kritere dhe te hiqen nga kerkesat qe duhet permbushen nga OE ofertues.

| **Përshtatshmëria profesionale:** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* |
|---|---|
| **1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit për ushtrimin e veprimtarisë** | **1. Kopja e Certifikatës se biznesit** |
| **Kapaciteti ekonomik dhe financiar:** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* |
| **1. Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit fiskale ka qenë prej jo më pak se Lot 1 - 480.000,00 Euro Lot 2 - 420.000,00 Euro Në rast të konzorciumit 60% duhet që të plotësoj udhëheqësi.** | |

| **Kapaciteti teknik dhe professional:** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare* |
|---|---|
| **1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme për shërbim në vlerë minimale prej Lot 1 360.000,00 Euro; Lot 2 315.000,00 Euro në 3 (tri ) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë).**<br><br>**2. Operatori ekonomike për të dy (2) Lotet duhet te angazhoj personelin profesional te cilët duhet te kenë kualifikimet shkollore te mëposhtme a. Një Epidemiolog I cili duhet të ketë Diplomë dhe Liçencë valide pune b. Një teknik sanitar ose inxhinier sanitar I cili duhet të ketë Diplomë c. Një Agronom ose Ekolog ose Biolog, me Diplomë dhe I certifikuar për menaxhimin e mjedisit. d. Minimumi 4 punëtortë trajnuar për përdorimin e produkteve biocide e. Minimumi 4 punëtorë tjerë teknik.**<br><br>**3. Preparatet deratizuese duhet të jenë në formë blloku me parafinë kundër lagështisë, antikuagulant të gjeneratës së dytë dhe Preparatet repelente në formë spreji për largimin e brejtësve.**<br><br>**4. Operatori Ekonomik duhet të jetë I pajisur me certifikata ISO Standard a) ISO Standard 9001 2015; b) ISO Standard 14001 2015; c) ISO Standard 45001 2018**<br><br>**5.Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimetet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Pasjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.** | **1. Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të shërbimeve.**<br><br>**2.Listën e punëtorëve të nënshkruar dhe vulosur nga OE a. Diploma ,Liçenca valide, kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. b. Diploma Certifikata, kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. c. Diploma dhe Certifikata e akredituar për menaxhimin e mjedisit, kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt . d. Certifikata për përdorim të produkteve biocide kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë project e. Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt.**<br><br>**3. Preparatet Deratizues duhet të kenë a) Listën teknike të sigurisë – (MSDS) për produktet e ofruara (kopje) b) Certifikatën e Analizave (kopje) c) Deklaratën e konfirmitetit nga prodhuesi për produktin bllok me parafine (kopje) Për preparatet repelente kundër brejtësve duhet të kenë Certifikatën e analizave dhe MSDS (kopje)**<br>**4. Certifikatat (kopje) e noterizuar me validitet 2022 a) ISO Standard 9001 2015; b) ISO Standard 14001 2015; c) ISO Standard 45001 2018**<br>**5. Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet qe regjistrohen. Ne rastet kur OE ka mareveshje per shfrytezimin, OE duhet te dorezoj edhe marreveshjen per shfrytezim.** |

## 3. KRITERI PER VLERSIM

**Tenderi i Pergjegjeshem me çmim me te ulet**

## 4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Nuk ka raport te vlerësimit pasi ankesa është para hapjes se Ofertave.

## 5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

***Nuk ka***

## 6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

/

## 7. PERGJIGJE NE PRETENDIMET ANKIMORE TE OE ANKUES "INFINITT SHPK "

**Pretendimi 1**

Shkelje e Nenit 1, Oellimi i aktivitetit te prokurimit. Qellimi i procedurave te prokurimit eshte gjetja e nje OE i cili i permbushe kriteret e nevojshme per te deshmuar se do ta realizoje me sukses kontraten dhe cmimi i tij i ofruar eshte me i liri nga konkurrentet. Autoriteti kontraktues ne kete rast per tu siguruar se OE fitues do ta realizoje me sukses dhe pergjegjesi profesionale kontraten, ne dosjen e tenderit ka vendosur me te drejte edhe kriterin qe OE ofertues duhet te jete i licencuar per te ushtruar veprimtari te DDD-se te leshuar nga ministria perkatese. Por vendosja e kriteri per staf shtese te kualifikuar per tituj akademik te caktuar eshte standarde i dyfishte dhe bie ne kundershtim me qellimin e aktivitetit te prokurimit.
Si dhe vlera e parashikuar eshte shume e larte ne krahazim me çmimet e tregut. Prandaj, koficienti i kerkeses per referenca duhet te kalkulohet mbi bazen e vleres reale te tregut.

**Përgjigjeje ne pretendimin 1**
Pretendimi i OE Ankues është se AK ka si qëllimi i aktivitetit te prokurimit është te gjej një OE qe i përmbushë kriteret e vlerësimit dhe qe realizimi i kontratës behëm me mënyre sa me te mire ekonomike dhe me efikasitet. Ndërsa sa i përket buxhetit te parashikuar qe është shume e larte qe OE Ankues e ka si pretendim ankimor eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Është mundet te jete si fakt qe buxheti i parashikuar te jet shume me i larte me vlerën e tregu si vlerësim i juaji pasi ju jeni kompani qe merrni me këto shërbime , mirëpo AK ka bere vlerësimin sipas parametrave qe at kane ne hulumtimin e tregut dhe këtë te drejt e ka AK se hulumtimin e bëjnë njësia kërkues dhe ky pretendim Ankimor mundet te jete pjesërisht i bazuar.

**Pretendimi 2**

Shkelje e Nenit 7, Barazia ne Trajtim / Jo-Diskriminimi. Autoriteti kontraktues me rastin e shpalljes se Njoftimit per kontrate dhe dosjes se tenderit ka vendosur kritere diskriminuese, duke kerkuar staf shtese te kualifikuar per tituj akademik te caktuar dhe neglizhuar kriterin baze qe ka te beje me licencen e leshuar nga institucionet perkatese per te ushtruar veprimtarine profesionale per ofrimin e sherbimeve te natyres se njejte siq ka kerkuar AK.

**Përgjigjeje ne pretendimin 2**

OE ankues ka si pretendim se AK i KK Prishtinës ka bere diskriminim kur ka kërkuar staf te kualifikuar ne tenderin e Shërbimeve per Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor dhe kriter tjetër Leja e lëshuar nga MBPZHR-ja, për kryerjen e shërbimeve të DDD-së e eksperti shqyrtues mendon .

Sipas ekspertit shqyrtues AK I Kuvendit Komunal Prishtinës ka bere kritere kufizues kur ka kërkuar stafe te kualifikuar dhe Leja- licenca e lëshuar nga MBPZHR-ja pasi vet MPBZHR-ja gjate licencimit te kompanive për shërbime DDD ka kërkuar vetëm njërin nga përgatitja profesionale Fakulteti I Bujqësisë , Agronomisë, Veterinarisë, Epidemiologjisë , Ekologjisë ndërsa per një tender te kërkohen staf te kualifikuar dhe licenca kjo është diskriminim pasi edhe tregu është shume I vogël- nuk ka shume OE qe kryejnë shërbimeve te DDD-se.

Gjithashtu kërkesa per Licence e AK është e arsyeshme ndërsa kërkesat per staf shtese te kualifikuar është ne kundërshtim me parimet e prokurimit pasi mundet te cilësohet si kritere favorizuese te ndonjë OE qe mundet te diskriminoj operatoret tjerë ekonomik.

Eksperti shqyrtues mendon se AK I KK Prishtinës ka mundësi te kërkoj vetëm licencën per shërbime DDD dhe te kërkoj staf teknik per kryerjen e shërbimeve qe te ju mundësohet sa me shume OE te kemi dhe most e kufizojmë konkurrencën me staf te kualifikuar , ne baze te kësaj te cekur me larte eksperti shqyrtues mendon se pretendim ankimor është I bazuar.

Ne baze te fakteve qe ka ofruar OE ankues një vendim te OSHP-se me nr. 492/15 dates 30.11.2015 si dhe vendimet e MBPZHR dhe përgjigjet e cekura me lart eksperti shqyrtues mendon se Ankesa e OE te cilësohet pjesërisht e bazuar dhe AK ti rishqyrtoj kriteret qe ka kërkuar ne Dosjen e tenderit pasi AK nëse do ti rishqyrton kriteret do te ju mundësohet me shume OE te ofertoj dhe te ken një treg me te sigurte.

## 8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar ne sqarimet e cekura me larte , Eksperti propozon **OSHP-se** qe ankesa e Operatorit Ekonomik ankues " MONUNI SHPK" qe te aprovohet pjesërisht e bazuar .

Eksperti shqyrtues ne përputhje me nenin 114 pika 2 rekomandon autoritetit kontraktues qe te shtyjeni afatin e dorëzimit te ofertave dhe ti rishqyrtojnë kriteret e vlerësimit te aktivitetit te prokurimit me titull **Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor** ne përputhje me dispozitat e LPP-se.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- -Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - " MONUNI SHPK"